



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**URDHER**

**Nr. 177, date 14.11.2005**

**PER**

**NGRITJEN E GRUPIT NDERINSTITUCIONAL TE PUNES PER HARTIMIN E  
MASTERPLANIT, PER SHTRIRJEN E TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT  
NE TE GJITHE SISTEMIN ARSIMOR**

Ne mbeshtetje te pikes 3, te nenit 102, te Kushtetutes dhe nenit 12, te Ligjit Nr. 9000, date 30.01.2003, "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave",

**U R D H E R O J:**

1. Ngritjen e grupit nderinstitucional te punes per hartimin e masterplanit, per shtrirjen e teknologjise se informacionit ne te gjithe sistemin arsimor.
2. Grupi i punes te kryesohet nga zevendesministri i Arsimit dhe Shkences dhe ne perberje te kete:

- a) 6 specialiste nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, perkatesisht:
- 2 specialiste nga Departamenti i Kurrikulave;
  - 1 specialist nga Departamenti i Teknologjise;
  - 1 specialist i trajnimeve per mesuesit;
  - 1 drejtor ose nendrejtor shkolle;
  - 1 specialist nga Drejtoria arsimore, rajonale e qytetit, Tirane.

Njeri prej specialisteve te jete koordinator per Ministrine e Arsimit dhe Shkences.

- b) 2 perfaqesues nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, perkatesisht:
- Keshilltari i ministrit;
  - Drejtori i Drejtorise se Teknologjise se Informacionit.
- c) 1 specialist nga Ministria e Brendeshme, qe mbulon pushtetin vendor dhe decentralizimin;
- ç) 1 specialist nga INICEF-i, projekti i arsimit;
- d) 1 specialist me kualifikim te larte nga Universiteti Politeknik;
- dh) 1 specialist nga INIMA;
- e) 1 specialist nga Departamenti i Administrates Publike.

Ne mbledhjet e grupit te punes ftohen te marrin pjese edhe specialiste te tjere, ne funksion te permbushjes se detyrave te ketij grupi.

3. Grupi i punes te mblidhet brenda 4 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij urdhri.
  
4. Grupi i punes, Brenda dates 10.12.2005, te paraqese prane kabinetit te Kryeministrit projektin perfundimtar te masterplanit qeveritar per shtrirjen e teknologjise se informacionit net e gjithe sistemin arsimor.
  
5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkences per mbeshtetjen materiale e teknike te veprimtarise se grupit te punes.

Ky udher hyn ne fuqi menjehere.

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**